

Tiranë, 16.01.2023

VËRTETIM PËRKTHIMI

Vërtetoj nënshkrimin e përkthyesit Ergys Bezhani, me Certifikatë Regjistrimi L31714014Q, përkthyes zyrtar për gjuhën angleze, i autorizuar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë, banues në Tiranë, deklaroj se e kam përkthyer saktësisht dokumentin bashkëngjitur nga anglishtja në shqip, duke e nënshkruar atë rregullisht.

TRANSLATION CERTIFICATION

I hereby certify that I, Ergys Bezhani with Certificate Registration L31714014Q, am an official translator for the English Language, authorised by the Ministry of Justice of the Republic of Albania, residing in Tirana, and that I accurately translated the attached document from English into Albanian, and duly signed it.

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
Ergys Bezhani
Nr. L31714014Q

KONTRATA "BAREBOAT" DHE MARRËVESHJA E SHËRBIMEVE O & M

2022

ndërmjet

EXCELERATE GLOBAL OPERATIONS LLC
si Pronari i Parë

dhe

RENCOS.P.A.
si Ofrues i Parë i Shërbimeve

dhe

KORPORATËS ELEKTRO ENERGJITIKE
SHQIPTARE - KESH
si
Kompani





TABELA E PËRMBAJTJES

Klauzola	Page
1. Përkufizimet dhe Interpretimet.....	4
2. Marrëveshja	8
3. Detyrimi	8
4. Rinovimi	9
5. Kushtet paraprake.....	11
6. Njoftimet.....	11
7. Konfidencialiteti.....	12
8. Të ndryshme	12
9. Ligji në Fuqi.....	13
10. Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve.....	13
Shtojca	
1. Bareboat.....	16
2. Marrëveshja e Shërbimeve	80
3. Ngjarjet e Përfunduar.....	104
4. Dokumentet e Tenderit.....	117
Nënshkrimet	115



Kjo KONTRATË "BAREBOAT" DHE MARRËVESHJE PËR SHËRBIMET O & M (kjo Marrëveshje) është lidhur me një akt dhe i përket vitit 2022

NDËRMJET:


- (1) **EXCELERATE GLOBAL OPERATIONS LLC**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas ligjeve të Delaware, me seli qendore të biznesit në 2445 Technology Forest Dr, The Woodlands, TX 77381, SHBA (Pronari i Parë);
- (2) **RENCO S.P.A.**, një shoqëri private e kufizuar e themeluar sipas ligjeve të Italisë me seli të regjistruar në Strada di Montefeltro 51, 61122 Pesaro, Itali (Ofruesi i Parë i Shërbimeve); dhe
- (3) **KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE - KESH**, shoqëri aksionare e themeluar sipas ligjeve të Shqipërisë me seli të regjistruar në Rr. Viktor Eftimiu, Blloku Vasil Shanto, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i Numrit të Identifikimit J61817005F, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv, z. Ergys Verdho (Kompania).

MEQËNËSE:

- (A) Kompania synon të operojë një anije termocentral në Portin e Peshkimit pranë qytetit të Vlorës në Shqipëri (Projekti).
- (B) Pronari është pronari disponues i dy termocentraleve HFO, në anije termocentral me dy komponentë të njohur si Tiger I dhe Tiger III.
- (C) Pronari ka rënë dakord për:
 - (i) zhvillimin, projektimin, punimet inxhinierike dhe ndërtimin e një infrastrukture të caktuar fikse në kantier;
 - (ii) kontrata "bareboat" dhe dhënien me qira të Objektit Pronarit; dhe
 - (iii) montimin e Objektit në Kantier,

në çdo rast, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në këtë Kontratë.

- (D) Kompania ka rënë dakord për:
 - (i) kontratën "bareboat" dhe dhënien me qira të Objektit nga Pronari;
 - (ii) që Renco SpA të operojë dhe të mirëmbajë Njësitë dhe Infrastrukturën Fikse në emër të Kompanisë;
 - (iii) të sigurojë dhe mirëmbajë të gjitha autorizimet, qiratë, të drejtat e tokës dhe lejet e tjera të kërkuara për Projektin, duke përfshirë importin e Njësive dhe Infrastrukturës Fikse në Shqipëri dhe eksportin e Njësive dhe Infrastrukturës



Fikse nga Shqipëria në fund të Periudhës së Kontratës; dhe

- (iv) çmontimin e Kantierit dhe mbajtjen e të gjithë përgjegjësisë në lidhje me këtë çmontim,

në çdo rast, për qëllimet e Projektit dhe në përputhje me dispozitat e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

- (E) Ofruesi i Shërbimeve është një kompani e angazhuar në furnizimin dhe instalimin e impianteve të gjenerimit të energjisë elektrike, si dhe operimin, mirëmbajtjen dhe servisimin e tyre.
- (F) Kompania dëshiron të angazhojë Ofruesin e Shërbimit, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, për të ofruar shërbime të caktuara dhe pjesë këmbimi për Objektivin dhe Ofruesi i Shërbimit dëshiron të angazhohet në këtë mënyrë duke marrë parasysh pagesën e Tarifave të Shërbimit.

ËSHTË RËNË DAKORD për sa më poshtë vijon:

1. PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME

1.1 Përkufizimet

Certifikata e Pranimi ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 1 (Kontrata "Bareboat").

Filial nënkupton, në lidhje me çdo person, një degë të atij personi ose një kompani aksionare e atij personi ose ndonjë filial tjetër i asaj shoqërie mbajtëse.

Menaxheri i Miratuar ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 1 (Marrëveshja "Bareboat").


Autorizim nënkupton një autorizim, pëlqim, lejim, vërtetim, leje, mospërputhje, miratim, rezolutë, licencë, qira, të drejtë mbi tokën, përjashtim, regjistrim, noterizim, depozitim ose regjistrim.

Ditë pune nënkupton një ditë (përveç të shtunës ose të dielës) në të cilën bankat janë të hapura për biznes të përgjithshëm në Hjuston, Romë, Nju Jork dhe Tiranë.

Marrëveshja ka kuptimin që i është dhënë në pikën 1.1(b) të Shtojcës 1 (Marrëveshja "Bareboat").

Kontroll nënkupton (drejtpërsëdrejti ose tërthorazi) pronësinë e më shumë se 50% të kapitalit aksionar me të drejtë vote (ose të drejtat ekuivalente të pronësisë) të një kompanie ose subjekti dhe kompetencën për të emëruar shumicën e drejtorëve të bordit të drejtorëve të kësaj kompanie ose subjekti.

Dollarë, USD ose \$ nënkupton monedhën e ligjshme herë pas here të Shteteve të



Bashkuara të Amerikës.

Euro, EUR ose **€** nënkupton monedhën e përbashkët të Shteteve Anëtare pjesëmarrëse.

Objekti nënkupton

- (a) Infrastrukturën Fikse; dhe
- (b) Njësitë.

Fitch nënkupton Fitch Ratings Ltd.

QSH nënkupton qeverinë e Republikës së Shqipërisë.

Autoriteti Qeveritar nënkupton:


- (a) çdo qeveri kombëtare;
- (b) çdo nënndarje politike, autoritet bankar ose monetar ose juridiksion lokal në një qeveri kombëtare;
- (c) çdo subjekt që i nënshtrohet kontrollit ose drejtimit të përgjithshëm në lidhje me çështjet e politikës së QSH-së ose që kontrollohet nga QSH-ja, duke përfshirë, pa kufizim, por vetëm për aq kohë sa është nën kontrollin e QSH-së, Kompaninë;
- (d) çdo instrument, komision bordi, autoritet, departament, organ, gjykatë ose agjenci të ndonjë prej subjekteve të listuara në paragrafët (a) ose (b);
- (e) çdo shoqatë, organizatë ose institucion, ku ndonjë nga subjektet e listuara në paragrafët (a) ose (b) është anëtar, ose subjekt i juridiksionit të tyre ose pjesëmarrës në aktivitetet e organizuara prej tyre; dhe
- (f) çdo person që vepron ose pretendon të veprojë në emër të ndonjë prej personave ose subjekteve të listuara në paragrafët (a) deri (e) përfshirë më lart.

Kompania Aksionare nënkupton, në lidhje me një person, çdo person tjetër në lidhje me të cilin ajo është degë.

I dëmshpërblyeri ka kuptimin e dhënë në Shtojcën 1 (Marrëveshja "Bareboat").

Ligji nënkupton:

- (a) çdo ligj, statut, dekret, kushtetutë, rregullore, autorizim, vendim, urdhëresë ose direktivë tjetër të çdo Autoriteti Qeveritar;



- (b) çdo traktat, konventë, kod, pakt, kompakt ose marrëveshje tjetër në të cilën çdo Autoritet Qeveritar është nënshkrues, palë ose shtet kontraktues; ose
- (c) çdo interpretim gjyqësor ose administrativ me karakteristika detyruese ose çdo zbatim të atyre që përshkruhen në pikën (a) ose (b) më sipër.

Specifikimet Minimale Funksionale kanë kuptimin e dhënë në Shtojcën 1 (Marrëveshja "Bareboat").

Pronari i Ri nënkupton Excelsior-Renco RPB, LLC, një kompani shqiptare me përgjegjësi të kufizuar me adresë të regjistruar në: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 3, Objekt me numër pasurie 40/32, zona kadastrale 2679.

Ofruesi i Ri i Shërbimeve nënkupton Renco Spark Sh.p.k, një kompani shqiptare në pronësi të Renco S.p.a.;

Data e Hyrjes në Fuqi e Novacionit ka kuptimin e dhënë këtij termi në pikën 4.1(b).

Njoftim i Rinovimit nënkupton një njoftim nga Pronari dhe Pronari i Ri kryesisht në formën e përcaktuar në **Burimi i referencës nuk u gjet** (Formulari i Njoftimit të Rinovimit).

Pronari nënkupton:

- (a) Pronarin e Parë; ose
- (b) çdo rinovim në përputhje me Klausolën 4 (Rinovim), Pronari i Ri.

Shtet Anëtar Pjesëmarrës nënkupton çdo shtet anëtar të Bashkimit Evropian që ka euron si monedhë të ligjshme në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian në lidhje me Bashkimin Ekonomik dhe Monetar.

Ngjarja e Mundshme e Ndërprerjes ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 1 (Marrëveshja "Bareboat").

Projekti ka kuptimin e dhënë në paragrafët e mësipërm.

Marrëveshja e Shërbimeve ka kuptimin e dhënë në pikën 1.1(a) të Shtojcës 2 (Marrëveshja e Shërbimeve)

Data e Hyrjes në Fuqi e Rinovimit të Marrëveshjes së Shërbimit ka kuptimin e dhënë këtij termi në pikën 4.2.

Njoftimi për Rinovimin e Marrëveshjes së Shërbimit nënkupton një njoftim nga Ofruesi i Parë i Shërbimit dhe Ofruesi i Ri i Shërbimit kryesisht në formën e përcaktuar në Shtojcën 5.

Ofruesi i Shërbimit nënkupton:

(a) Ofruesin e Parë të Shërbimit; ose

(b) pas çdo rinovimi në përputhje me Klausolën 4 (Rinovimi), Ofruesi i Ri i Shërbimit.

S&P nënkupton Shërbimet e Vlerësimit Standard & Poor's, një sektor i Kompanive McGraw-Hill, Inc. ose ndonjë pasues të biznesit të tij të vlerësimit.

Shërbimet e Abonimit kanë kuptimin e dhënë në Shtojcën 2 (Marrëveshja e Shërbimeve).

Dega e një personi nënkupton çdo person tjetër:

(a) Drejtpërdrejt ose tërthorazi të kontrolluar nga ky person; ose

(b) nga dividendët ose shpërndarjet e të cilit mbi kapitalin aksionar të zakonshëm me të drejtë vote, ky person ka të drejtë të marrë më shumë se 50% (pesëdhjetë për qind).

Tatim ose taksë nënkupton çdo taksë aktuale dhe të ardhshme (përfshirë, pa kufizim, tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimin mbi konsumin, çdo taksë tjetër në lidhje me vlerën e shtuar ose çdo të ardhur të tillë si taksat e mbajtura në burim, taksat e mallrave, detyrimet doganore, taksat e importit) dhe çdo mbajtje në burim të një natyre të ngjashme (duke përfshirë çdo gjobë, interes ose kamatëvonesë të pagueshme në lidhje me çdo mospagesë ose ndonjë vonesë në pagimin e ndonjë prej të njëjtave); dhe taksat dhe tatimet do të interpretohen në përputhje me rrethanat.


Zbritje e Taksave nënkupton zbritjen ose mbajtjen në burim për ose për llogari të Taksave nga një pagesë sipas një Dokumenti Transaksioni që kërkohej të bëhet nga Kompania nga një pagesë sipas një Dokumenti Transaksioni.

Ngjarja e Ndërprerjes ka kuptimin e dhënë në Shtojcën 1 (Marrëveshja "Bareboat").

Dokumentet e Tenderit kanë kuptimin e Thirrjes për Shprehje Interesi dhe ofertës së ofruar nga Pronari dhe Ofruesi i Shërbimeve

Humbje Totale nënkupton

(a) humbjen totale aktuale, konstruktive, të komprometuar ose të rregulluar të një Njësie; ose



- (b) shkatërrimin, dëmtimin përtej riparimit ekonomik ose bërjen e përhershme të papërshtatshme për përdorim normal të një Njësie; ose
- (c) kërkesën për titull, konfiskim ose blerje të tjera të detyrueshme nga një autoritet qeveritar i një Njësie; ose
- (d) rrëmbimin, vjedhjen, dënimin, kapjen, sekuestrimin, konfiskimin, kërkesën për qira ose bllokimin për më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë të Njesisë.

Dokumentet e Transaksionit nënkuptojnë:

- (a) këtë Marrëveshje;
- (b) Certifikatën e Pranimi; dhe
- (c) çdo dokument, instrument ose marrëveshje tjetër që është rënë dakord me shkrim nga Pronari dhe Kompania si dokument transaksioni.

Njësia nënkupton:

- (a) Njësinë 1; ose
- (b) Njësinë 2,

dhe Njësitë nënkuptojnë të dyja së bashku.

Njësia 1 nënkupton termocentralin HFO, i montuar në maunë, i njohur si Tiger I, duke përfshirë pjesët rezervë, pajisjet, makineritë, kaldajat, bashkimet dhe rakorderitë siç përshkruhet më tej në Specifikimet Minimale Funksionale.

Njësia 2 nënkupton termocentralin HFO, i montuar në maunë, i njohur si Tiger II, duke përfshirë pjesët rezervë, pajisjet, makineritë, kaldajat, bashkimet dhe rakorderitë siç përshkruhet më tej në Specifikimet Minimale Funksionale.


TVSH-ja nënkupton çdo taksë mbi vlerën e shtuar, taksë mbi të ardhurat bruto, taksë shitjeje ose taksë të ngjashme indirekte kudo që të aplikohet.

TEC-i i Vlorës nënkupton termocentralin me cikël të kombinuar VLORE pranë qytetit të Vlorës, në Shqipëri.

1.2 Interpretimi


Në këtë Marrëveshje, përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe, çdo referencë për:

- (i) një palë është palë e kësaj Marrëveshjeje;
- (ii) kjo Marrëveshje përfshin Shtojcat, Anekset dhe Shtojcat e kësaj Marrëveshjeje dhe referencat e Klauzolave, Shtojcave, Anekseve dhe Programet janë, përveç



rasteve kur specifikohet ndryshe, referenca për Klauzolat dhe Shtojcat, Anekset dhe Programet e kësaj Marrëveshjeje (ose, sipas rastit, të Kontratës ose Marrëveshjes së Shërbimeve);

- (iii) çdo dispozitë statutoire ose legjislativ do të interpretohet duke përfshirë çdo modifikim ligjor ose legjislativ ose rikthim të tij ligjor, ose çdo zëvendësim të tij;
- (iv) termi **Njësi** përfshin çdo pjesë të një Njësie;
- (v) termi **Objekt** përfshin çdo pjesë të Objektit;
- (vi) **Pronari, Kompania, Ofruesi i Shërbimeve, Menaxheri i Miratuar** ose çdo person tjetër përfshijnë cilindo nga pasuesit e tyre përkatës, personat e caktuar të autorizuar dhe të transferuarit e autorizuar;
- (vii) çdo marrëveshje, instrument ose dokument përfshin një marrëveshje, instrument ose dokument të tillë që po i njëjti herë pas here mund të ndryshohet, modifikohet, plotësohet, rinovohet ose zëvendësohet;
- (viii) **këtu, po këtu, më poshtë** dhe fjalë të tjera të ngjashme nënkupton këtë Marrëveshje në tërësi (duke përfshirë Shtojcat dhe Programet) dhe jo ndonjë pjesë të veçantë të kësaj Marrëveshjeje;
- (ix) **ligji** përfshin të drejtën e zakonshme ose zakonore dhe çdo kushtetutë, dekret, aktgjykim, legjislacion, urdhër, urdhëresë, rregullore, rregull, statut, traktat ose masë tjetër legjislativ në çdo juridiksion ose çdo direktivë, rregullore, kërkesë ose kritere aktuale ose të ardhshme, ose interpretimin zyrtar ose gjyqësor të ndonjë prej sa më sipër, që në secilin rast ka fuqinë e ligjit dhe, nëse nuk ka fuqinë e ligjit, në zbatim të asaj pajtueshmërie që është përgjithësisht e zakonshme;
- (x) **fjala person** ose **persona** ose fjalët **persona** importues përfshijnë, pa kufizim, çdo shtet, ndarje administrative të një shteti, qeveri, individë, partneritete, korporata, sipërmarrje, agjenci qeveritare, komisione, departamente, autoritete dhe organe të tjera, të themeluara ose të pa themeluara, pavarësisht nëse kanë personalitet juridik të veçantë ose jo;
- (xi) **fjala përfshirë** do të interpretohet si **përfshirë, por pa u kufizuar në**.
- (xii) **mbyllja, shpërbërja, administrimi, likuidimi, paaftësia paguese, riorganizimi, lehtësimi i kushteve të borxhit, pezullimi i pagesave, moratoriumi ose falimentimi** (dhe derivatet e tyre dhe shprehjet e afërta) të çdo personi do të interpretohen secila në mënyrë që të përfshijë aspektet e tjera dhe çdo procedurë ose ngjarje ekuivalente ose analoge sipas ligjeve të çdo juridiksioni në të cilin ky personi është inkorporuar ose çdo juridiksioni në të



cilin ky person ushtron biznes;

- (xiii) një Ngjarje e Mundshme e Ndërprerjes që po vazhdon është referencë për një Ngjarje të Mundshme të Ndërprerjes e cila nuk korrigjohet ose nga e cila hiqet dorë; një Ngjarje e Ndërprerjes që po vazhdon është referencë për një Ngjarje Ndërprerjeje, nga e cila nuk hiqet dorë; dhe
- (xiv) fjalët që tregojnë numrin shumë përfshijnë njëjës dhe anasjelltas.
- (b) Titujt janë vetëm për qëllime referimi, nuk kanë asnjë domethënie ligjore ose të ngjashme dhe nuk do të merren parasysh në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje.
- (c) Ora (nëse nuk specifikohet ndryshe) është referencë për orën e Tiranës.

1.3 Të drejtat e palëve të treta


- (a) Një person që nuk është palë e kësaj Marrëveshjeje nuk ka të drejtë sipas dispozitave të Aktit të Kontratës (Të Drejtat e Palëve të Treta) të vitit 1999 të zbatojë përfitimin e ndonjë kushti të kësaj Marrëveshjeje dhe palët në këtë Marrëveshje nuk kërkojnë pëlqimin e ndonjë pale të tretë për të ndryshuar ose anuluar këtë Marrëveshje në çdo kohë.

2. MARRËVESHJA

- 2.1 Pronari pranon të japë dhe Kompania pranon të marrë me qira Objektin sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në Shtojcën 1 (Marrëveshja "Bareboat").
- 2.2 Ofruesi i Shërbimeve pranon të kryejë, ose të sigurojë kryerjen e Shërbimeve të Abonimit sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në Shtojcën 2 (Marrëveshja e Shërbimeve).

3. DETYRIMI

- 3.1 Secila palë në këtë Marrëveshje hyn në këtë Marrëveshje vetëm në emër të saj dhe sipas kësaj Marrëveshjeje janë një sërë detyrimesh për secilën palë. Si rrjedhim:
 - (a) Pronari nuk do të ketë asnjë detyrim për përmbushjen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve të detyrimeve të Ofertuesit të Shërbimeve sipas dhe në përputhje me Marrëveshjen e Shërbimeve; dhe
 - (b) Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë asnjë detyrim për përmbushjen nga ana e Pronarit të detyrimeve të Pronarit sipas dhe në përputhje me Kontratën.
 - (c) Detyrimi i Kompanisë ndaj Pronarit dhe Ofruesit të Shërbimeve është sipas përcaktimeve të bëra në Kontratën dhe Marrëveshjen përkatëse të Shërbimeve.
- 3.2 Si Kontrata, ashtu edhe Marrëveshja e Shërbimeve mund të ndërpriten vetëm në përputhje me kushtet e tyre përkatëse. Ndërprerja e Marrëveshjes së Shërbimeve nuk do




të ketë ndikim në detyrimet e Kompanisë sipas ose në përputhje me Kontratën.

- 3.3 Për shmangien e dyshimit, detyrimet e pagesave të Kompanisë sipas Marrëveshjes janë të pavarura dhe do të faturohen dhe shlyhen në përputhje me Marrëveshjen veçmas nga detyrimet e pagesës së Kompanisë sipas Marrëveshjes së Shërbimeve dhe nuk janë subjekt i ndonjë zbritje, reduktimi, kompensimi, përjashtimi, justifikimi, kundërkërkese, rimbursimi ose ndonjë të drejte tjetër që Kompania mund të ketë kundër Ofruesit të Shërbimeve.

4. RINOVIMI

4.1 Rinovimi i Kontratës

- (a) Pronari i Parë mund t'ia transferojë me anë të rinovimit të gjitha të drejtat dhe detyrimet në dhe në përputhje me këtë Marrëveshje Pronarit të Ri duke i dërguar një Njoftim për Rinovim Kompanisë dhe Ofruesit të Shërbimit.
- (b) Pas marrjes nga Kompania dhe Ofruesi i Shërbimit të një Njoftimi për Rinovim të nënshkruar nga Pronari i Parë dhe Pronari i Ri (data e këtij Njoftimi për Rinovim është **Data e Hyrjes në Fuqi të Rinovimit**) të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Pronarit të Parë në dhe në përputhje me Dokumentet e Transaksionit do t'i transferohen Pronarit të Ri në përputhje me dispozitat e mëposhtme:
- (i) Me Hyrjen në Fuqi të Datës së Rinovimit:
- (A) Dokumentet e Transaksionit do të lexohen dhe interpretohen në të gjitha aspektet në mënyrë të tillë sikur Pronari i Ri të kishte qenë gjatë gjithë kohës palë në Dokumentet e Transaksionit në vend të Pronarit të Parë (duke qenë subjekt vetëm i kushteve të tjera të këtij Akti);
- (B) Si Kompania, ashtu edhe Ofruesi i Shërbimeve e çliron Pronarin e Parë nga detyrimet e tij sipas Dokumenteve të Transaksionit;
- (C) Pronari i Parë e çliron Kompaninë dhe Ofruesin e Shërbimit nga detyrimet e tyre përkatëse ndaj Pronarit të Parë sipas Dokumenteve të Transaksionit ((duke qenë subjekt vetëm i kushteve të tjera të kësaj Marrëveshjeje);
- (D) Çdo Dokument Transaksioni do të formojë detyrimet detyruese të secilës palë ndaj këtyre dokumenteve në përputhje me kushtet e tyre.
- (ii) Si Kompania, ashtu edhe Ofruesi i Shërbimit marrin përsipër që nga Data e Hyrjes në Fuqi të Rinovimit të respektojnë, kryejnë, shlyejnë dhe t'u përgjigjet të gjitha detyrimeve dhe përgjegjësi të tyre sipas




Dokumenteve të Transaksionit në mënyrë të tillë sikur Pronari i Ri të kishte qenë gjatë gjithë kohës palë në Dokumentet e Transaksionit në vend të Pronarit të Parë. Pa kufizuar sa më sipër, si Kompania, ashtu edhe Ofruesi i Shërbimit bien dakord në mënyrë të pakthyeshme dhe të pakushtëzuar që do të jenë tërësisht përgjegjës për çdo detyrim ose përgjegjësi të shkaktuar prej tyre sipas Dokumenteve të Transaksionit para Datës së Hyrjes në Fuqi të Rinovimit, të cilat janë të papaguara që nga Data e Hyrjes në Fuqi të Rinovimit.

- (iii) Kompania pranon se pas Datës së Hyrjes në Fuqi të Rinovimit nuk do të ketë asnjë pretendim të mëtejshëm ndaj Pronarit të Parë në lidhje me Dokumentet e Transaksionit.
- (iv) Ofruesi i Shërbimit pranon se pas Datës së Hyrjes në Fuqi të Rinovimit nuk do të ketë asnjë pretendim të mëtejshëm ndaj Pronarit të Parë në lidhje me Dokumentet e Transaksionit.
- (v) Pronari i Parë pranon se pas Datës së Hyrjes në Fuqi të Rinovimit, nuk do të ketë asnjë pretendim të mëtejshëm ndaj Kompanisë në lidhje me Dokumentet e Transaksionit.

4.2 Rinovimi i Marrëveshjes së Shërbimeve

- (a) Ofruesi i Parë i Shërbimit mund t'i transferojë me anë të rinovimit të gjitha të drejtat dhe detyrimet në këtë Marrëveshje dhe në përputhje me të Ofruesi i Ri i Shërbimit duke i dërguar një Njoftim Rinovimi për Marrëveshjen e Shërbimeve Kompanisë dhe Pronarit.
- (b) Pasi Kompania dhe Pronari të marrin Njoftimin e Rinovimit të Marrëveshjes së Shërbimeve të nënshkruar si nga Ofruesi i Parë i Shërbimit, ashtu edhe nga Ofruesi i Ri i Shërbimit (data e këtij Njoftimi të Rinovimit është **Data e Hyrjes në Fuqi e Rinovimit të Marrëveshjes së Shërbimit**) të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Ofruesit të Parë të Shërbimit në Dokumentet e Transaksionit dhe në përputhje me to do t'i transferohen Ofruesit të Ri të Shërbimeve në përputhje me dispozitat e mëposhtme:
 - (i) Me Hyrjen në Fuqi të Datës së Rinovimit të Marrëveshjes së Shërbimit:
 - (A) Dokumentet e Transaksionit do të lexohen dhe interpretohen në të gjitha aspektet në mënyrë të tillë sikur Pronari i Ri i Shërbimit të kishte qenë gjatë gjithë kohës palë në Dokumentet e Transaksionit në vend të Pronarit të Parë (duke qenë subjekt vetëm i kushteve të tjera të këtij Akti);
 - (B) Si Kompania ashtu edhe Pronari çliron Ofruesin e Parë të Shërbimit nga detyrimet e tij sipas Dokumenteve të



Transaksionit;

- (C) Ofruesi i Parë i Shërbimit çliron Kompaninë dhe Pronarin nga detyrimet e tyre përkatëse ndaj Ofruesit të Parë të Shërbimit sipas Dokumenteve të Transaksionit (që janë subjekt vetëm i kushteve të tjera të kësaj Marrëveshjeje);
 - (D) çdo Dokument Transaksioni do të formojë detyrimet detyruese të secilës palë ndaj tij këtyre Dokumenteve në përputhje me kushtet e tyre
- (ii) Si Kompania, ashtu edhe Pronari marrin përsipër që nga Data e Hyrjes në Fuqi të Rinovimit të respektojnë, kryejnë, shlyejnë dhe t'u përgjigjen të gjitha detyrimeve dhe përgjegjësi të tyre sipas Dokumenteve të Transaksionit në mënyrë të tillë sikur Ofruesi i Ri i Shërbimeve të kishte qenë gjatë gjithë kohës palë në Dokumentet e Transaksionit në vend të Ofruesit të Parë të Shërbimeve. Pa kufizuar sa më sipër, si Kompania, ashtu edhe Pronari bien dakord në mënyrë të pakthyeshme dhe të pakushtëzuar që do të jenë tërësisht përgjegjës për çdo detyrim ose përgjegjësi të shkaktuar prej tyre sipas Dokumenteve të Transaksionit para Datës së Hyrjes në Fuqi të Rinovimit të Marrëveshjes së Shërbimeve, të cilat janë të papaguara që nga Data e Hyrjes në Fuqi të Rinovimit të Marrëveshjes së Shërbimit.
 - (iii) Kompania pranon se pas Datës së Hyrjes në Fuqi të Rinovimit të Marrëveshjes së Shërbimit nuk do të ketë asnjë pretendim të mëtejshëm ndaj Ofruesit të Parë të Shërbimit në lidhje me Dokumentet e Transaksionit.
 - (iv) Pronari pranon se pas Datës së Hyrjes në Fuqi të Rinovimit të Marrëveshjes së Shërbimit nuk do të ketë asnjë pretendim të mëtejshëm ndaj Ofruesit të Parë të Shërbimit në lidhje me Dokumentet e Transaksionit.
 - (v) Ofruesi i Parë i Shërbimit pranon se pas Datës së Hyrjes në Fuqi të Rinovimit të Marrëveshjes së Shërbimit, nuk do të ketë asnjë pretendim të mëtejshëm ndaj Kompanisë ose Pronarit në lidhje me Dokumentet e Transaksionit.

5. KUSHTET PARAPRAKE

Detyrimet e Pronarit dhe Ofruesit të Shërbimit sipas kësaj Marrëveshjeje janë subjekt i marrjes (ose heqjes dorë nga marrja) nga ana e Pronarit dhe Ofruesit të Shërbimit të të gjitha dokumenteve dhe provave të tjera të renditura në Pjesën 1 të Programit 5 (Kushtet paraprake dhe kushtet pasuese) të Shtojcës 1 (Marrëveshja "Bareboat") në formë dhe substancë të kënaqshme për Pronarin dhe Ofruesin e Shërbimit.



6. NJOFTIMET

6.1 Komunikimet me shkrim

Çdo komunikim që do të bëhet sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të bëhet me shkrim dhe mund të bëhet me anë të letrave ose e-mailit.

6.2 Adresat

- (a) Detajet e kontaktit për çdo komunikim që do të bëhet ose do të dorëzohet sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje janë si më poshtë:

(i) Pronari:

Adresa: 2445 Technology Forest, level 6

The Woodlands, TX 77381, USA

E-mail: Notices@accelerateenergy.com

Për dijeni të: Drejtuesi Tregtar

(ii) Kompania:

Adresa: Rr. Viktor Efimi, Blloku Vasil Shanto, Tiranë, Shqipëri

E-mail: info@keah.al

Për dijeni të: Drejtorit Ekzekutiv, Z. Ergys Verdho

(iii) Ofruesi i Shërbimit:

Adresa: TIRANË, Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 2, objekt me numër pasurie 40/32, zona kadastrale Nr. 2679

E-mail: Valerio.capozzella@renco.it


Për dijeni të: Valerio Capozzella

- (b) Secila Palë mund të ndryshojë të dhënat e saj të kontaktit duke u dhënë njoftim Palëve të tjera pesë (5) ditë pune më përpara.

6.3 Dorëzimi

- (a) Përveç rasteve që parashikohen më poshtë, çdo komunikim i bërë ose i dorëzuar nga njëra palë te një tjetër sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje do të hyjë në fuqi vetëm:

- (i) nëse bëhet me anë të një letre dorëzuar në adresën përkatëse ose pasi është depozituar pesë (5) ditë pune para në shërbimin postar të parapaguar në një zarf të adresuar në atë adresë; ose



- (ii) nëse bëhet me anë të komunikimit elektronik kur aktualisht merret në formë të lexueshme,

dhe, nëse një departament apo zyrtar i caktuar është specifikuar si pjesë e detajeve të adresës së kësaj Marrëveshjeje të dhëna në Klauzolën 6.2 (Adresat), në rast se i drejtohet atij departamenti apo zyrtari.

- (b) Çdo komunikim i cili hyn në fuqi në një ditë pushimi javor ose ditë feste zyrtare ose pas orarit të punës në vendin e marrjes do të konsiderohet se hyn në fuqi vetëm ditën tjetër të punës në atë vend.

7. KONFIDENCIALITETI

Gjatë gjithë kohës pas datës së kësaj Marrëveshjeje dhe gjatë Periudhës së Kontratës, Kompania do të ruajë konfidencialitetin dhe nuk do t'i bëjë publike asnjë personi, pa pëlqimin paraprak me shkrim të pronarit:

- (a) Dokumentet e Transaksionit ose transaksionet e parashikuara nga këto Dokumente Transaksionesh; ose
- (b) çdo informacion të dhënë në bazë të ndonjë prej këtyre dokumenteve të transaksionit, me kusht që Kompania të mund të bëjë publike çdo informacion të tillë pa pëlqimin paraprak:
- (i) çdo personi në masën që kërkohet për qëllimin e çdo procesi gjyqësor, arbitrazhi apo procesi ose procedure rregullatore;
- (ii) çdo personi të cilit, dhe në masën që, kërkohet të bëhet publik informacioni nga ndonjë ligj ose rregullore në fuqi;
- (iii) çdo autoriteti qeveritar;
- (iv) auditorëve, këshilltarëve ligjorë, financiarë ose të sigurimit ose ndërmjetësve të Kompanisë, të cilët, në çdo rast, do të udhëzohen ose kanë detyrimin profesional për të ruajtur konfidencialitetin e çdo informacioni që u jepet; ose
- (v) në çfarëdo lloj mënyre të parashikuar në ndonjë nga Dokumentet e Transaksionit

8. TË NDRYSHME

8.1 Heqja dorë, mjetet juridike kumulative

- (a) Pamundësia ose vonesa nga ana e Pronarit ose Ofruesit të Shërbimit në ushtrimin e ndonjë kompetence, të drejte ose mjeti juridik sipas kësaj Marrëveshjeje ose në lidhje me Objektin nuk do të konsiderohet si heqje dorë prej saj dhe asnjë ushtrim i vetëm ose i pjesshëm i ndonjë të drejte, kompetence ose mjeti juridik të tillë nuk përjashton ndonjë ushtrim tjetër ose të mëtejshëm të ndonjë të kësaj të drejte ose kompetence ose

ushtrimin e ndonjë të drejte, kompetence ose mjete tjetër juridik.

- (b) Të drejtat dhe mjetet juridike përkatëse që i janë dhënë Pronarit dhe Ofruesit të Shërbimit nga kjo Marrëveshje janë kumulative, mund të ushtrohen aq herë sa Pronari ose Kompania (sipas rastit) e konsiderojnë të arsyeshme, janë shtesë dhe nuk përjashtojnë ndonjë të drejte dhe mjet juridik të parashikuar me ligj.

8.2 Mungesa e Partneritetit

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk krijon, përbën ose evidenton ndonjë partneritet, sipërmarrje të përbashkët, agjenci, trust ose marrëdhënie punëdhënësi/punonjësi midis palëve dhe asnjë palë nuk mund të bëjë ose të lejojë të bëhet ndonjë deklaratë zyrtare ku të deklarohet se një marrëdhënie e tillë ekziston midis palëve. Asnjëra prej palëve nuk do të ketë autoritetin të veprojë ose të marrë ndonjë detyrim në emër të palës tjetër, përveç rasteve që parashikohen shprehimisht në këtë Marrëveshje.

8.3 Dispozitat që Mbeten në Fuqi

Nëse një dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme në ndonjë juridiksion, kjo nuk do të ndikojë:

- (a) ligjshmërinë, vlefshmërinë ose zbatueshmërinë në atë juridiksion të çdo dispozite tjetër të kësaj Marrëveshjeje; ose
- (b) ligjshmërinë, vlefshmërinë ose zbatueshmërinë në çdo juridiksion tjetër të asaj dispozite ose të ndonjë dispozite tjetër të kësaj Marrëveshjeje.

8.4 Varianti

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk do të ndryshohen përveçse nga një instrument me shkrim të ekzekutuar nga ose në emër të Pronarit, Ofruesit të Shërbimeve dhe Kompanisë me kusht që:

- (a) dispozitat e Shtojcës 1 (Marrëveshja "Bareboat") mund të ndryshohen me anë të një instrumenti me shkrim të ekzekutuar nga ose në emër të Pronarit dhe Kompanisë me kusht që ky ndryshim nuk do të ndryshojë ose nuk ka për synim të ndryshojë ndonjë të drejtë, detyrim ose përgjegjësi të Ofruesit të Shërbimit pa pëlqimin paraprak me shkrim të Ofruesit të Shërbimeve; dhe
- (b) dispozitat e Shtojcës 2 (Marrëveshja e Shërbimeve) mund të ndryshohen me anë të një instrumenti me shkrim të ekzekutuar nga ose në emër të Ofruesit të Shërbimeve dhe Kompanisë me kusht që ky ndryshim nuk do të ndryshojë ose nuk ka për synim të ndryshojë ndonjë të drejtë, detyrim ose përgjegjësi të Pronarit pa pëlqimin paraprak me shkrim të Pronarit; dhe

8.5 Dokumentet e Tenderit



Palët pranojnë se kjo Marrëveshje është rezultat i negociatave në lidhje me Dokumentet e Tenderit të cilat janë bashkangjitur si Shtojca 4 vetëm për qëllime referimi.

8.6 Kopje e Dokumenteve Ligjore

Kjo Marrëveshje mund të ekzekutohet në shumë kopje ligjore dhe çdo kopje e vetme ose një sërë kopjesh të nënshkruara, në secilin rast, nga të gjitha palët do të konsiderohet se përbën një marrëveshje të plotë dhe origjinale për të gjitha qëllimet.

9. LIGJI NË FUQI

Kjo Marrëveshje dhe çdo detyrim jashtëkontraktor që rrjedh nga ose në lidhje me të do të rregullohet nga ligji anglez.


10. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

10.1 Ligji në Fuqi

Kjo Klausolë 10 (Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve) do të rregullohet nga ligji anglez.

10.2 Arbitrazhi

- (a) Çdo mosmarrëveshje, pretendim, mospajtim ose polemikë që lind nga, që ka të bëjë me ose që ka ndonjë lidhje me këtë Marrëveshje, duke përfshirë çdo mosmarrëveshje në lidhje me ekzistencën, vlefshmërinë, interpretimin, performancën, shkeljen ose ndërprerjen ose pasojat e pavlefshmërisë së saj dhe çdo mosmarrëveshje në lidhje me çdo detyrim jashtëkontraktor që rrjedh nga ose në lidhje me të (për qëllimin e Klausolës 10, **Mosmarrëveshja**), do të referohet dhe do të zgjidhet përfundimisht nga arbitrazhi sipas Rregullave të Arbitrazhit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit të Londrës (LCIA) të ndryshuar herë pas here (për qëllim të Klausolës 10, **Rregullat**)
- (b) Rregullat janë përfshirë duke iu referuar kësaj Klausole dhe termat e përdorur në këtë Klausolë me shkronja të mëdha të cilat nuk janë përcaktuar ndryshe në këtë Marrëveshje kanë kuptimin që u jepet atyre në klausolën e Rregullave.
- (c) Numri i arbitrave do të jetë tre. Padiësi do të emërojë dhe caktojë një arbitër nga Gjykata e LCIA-s. I padituri do të emërojë dhe caktojë një arbitër nga Gjykata e LCIA-s. Gjykata e LCIA-s do të caktojë arbitrin kryesues.
- (d) Secila palë:
- (i) pajtohet dhe jep pëlqimin shprehimisht për këtë procedurë për emërimin dhe caktimin e Tribunalit të Arbitrazhit; dhe
- (ii) në masën që nuk i lejohet të zgjedhë arbitrin e vet në përputhje me këtë



Klauzolë, heq dorë në mënyrë të përvokueshme dhe pa kushte nga çdo e drejtë për të zgjedhur arbitrin e vet.

- (e) Selia ose vendi ligjor i arbitrazhit do të jetë Londra.
- (f) Juridiksioni i gjykatave angleze sipas Aktit të Arbitrazhit s45 dhe s69 të vitit 1996 përjashtohet.
- (g) Gjuha e përdorur në procedurën e arbitrazhit do të jetë gjuhë angleze. Të gjitha dokumentet e paraqitura në lidhje me procedurat duhet të jenë në gjuhën angleze, ose, nëse janë në gjuhë tjetër, duhet të shoqërohen të përkthyer në anglisht.

10.3 Mosmarrëveshjet teknike

- (a) Pavarësisht Klausolës 10.2 të sipër përmendur, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve që ka të bëjë vetëm me çështjet teknike në lidhje me ndërtimin e Objektivit, materialet, projektimin me defekt, defektet, punimin ose performancën e Objektivit dhe/ose rezultatet e vënies në punë do t'i referohen një ekspert, në cilësinë e një eksperti dhe jo të një arbitri:
- (b) Nëse palët nuk arrijnë brenda shtatë (7) ditëve të bien dakord për identitetin e një eksperti teknik të pranueshëm reciprokisht, siç u përmend më lart, emërimi do të bëhet nga Instituti Mbretëror i Arkitektëve Detarë, Londër. Eksperti i caktuar në këtë mënyrë nuk duhet të jetë shtetas i vendit të themelimit të ndonjë pale dhe do të jetë i pavarur nga palët. Vendimi i ekspertit është përfundimtar dhe detyrues për palët.
- (c) Shpenzimet e çdo eksperti të caktuar në përputhje me Klausolën 10.3 së bashku me shpenzimet e këtyre procedurave do të paguhet nga pala humbëse ose sipas vendimit të ekspertit.

10.4 Heqja e Imunitetit

Në masën që çdo palë ka aktualisht apo më vonë ka ose fiton ndonjë imunitet, duke përfshirë, pa kufizim, imunitetin sovran, nga juridiksioni i çdo gjykate ose nga çdo proces ligjor (qoftë nëpërmjet shërbimit ose njoftimit, urdhër ndalimit, urdhër ndalimit në ndihmë të ekzekutimit, ekzekutimit ose në ndonjë formë tjetër), në lidhje me këtë palë ose pronën e saj, kjo palë heq dorë, në masën më të madhe të lejuar nga ligji, nga ky imunitet në lidhje me të gjitha detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje dhe Dokumenteve të Transaksionit sipas rastit.

KJO MARRËVESHJE është lidhur si akt në datën e përcaktuar në fillim të kësaj Marrëveshjeje.

